



Dt. 06/02/2018

### **KONTRATA PUBLIKE KORNIZË, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA**

## **PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË**

**KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

Dhe

"Niti - N" Sh.P.K, nga Prishtina , adresa: "Ulpiana A1-Lokali 2A", me numër të regjistrimit të biznesit 71064727 dhe me numër fiskal 601122716 e përfaqësuar nga Naim Zymeri – drejtor, në tekstin e më tejmë ("Ofruesi i shërbimeve"), janë pajtuar për realizimin e shërbimet në vijim:

### **Servisimi dhe mirembajtja e automjeteve te Komunes - pjesa e II-të**

**Nr. i brenshëm: 616-17-004-2-2-1**

#### **Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbirive në vijim: furnizimi dhe dorëzimi i pjesëve rezerve për automjete, si dhe kryerja e shërbimeve ndihmëse (servisimet e rregullta, instalimi i pjesëve rezerve, mirëmbajtje, riparimi i automjeteve etj) nga Ofruesi i Shërbimeve siç është përcaktuar ne Dosjen e tenderit.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjeter Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sositë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendorur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me nga dita e nënshkrimit të kontratës nga ana e te dy palëve dhe kohëzgjatja e saj është në afat prej 36 muajve.

#### **Neni 2 Koha e përfundimit**

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë [2 ] ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në punëtorinë e ofruesit të shërbimeve në Prishtinë përkatësisht ne Matiqan rruga e Zllatarit.

#### **Neni 3 Çmimi**

1.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve e që është çmimi i poentuar në vlerë prej: **326.885,<sup>20</sup> euro**.

3.1.2 Vlera totale indikative e kontratës është deri në: **40.000,<sup>00</sup> Euro. (katërdhjetë mijë)** euro. Devijimi i lejuar nga vlera totale indikative është **plus /minus + - 30%**.

3.2 Çmimi i përmendorur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të janë fikse dhe nuk do ti nënshtronen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

3.5 Autoriteti Kontraktues do t'i paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar për çdo muaj për muajin paraprak pas përfundimit të shërbimeve si dhe konstatimit nga personat e autorizuar se shërbimet janë përfunduar sipas kërkesave dhe specifikimit teknik

#### Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kérkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të sigruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshtësia në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" "do të shenohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet Shqipe në kater origjinalë, tri origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

| Për Autoritetin Kontraktues |                        | Për Kontraktuesin |              |
|-----------------------------|------------------------|-------------------|--------------|
| Emri:                       | Zekë Bardhaj           | Emri:             | Naim - ZYMER |
| Pozita:                     | Udhëheqës i prokurimit | Pozita:           | REZTOR       |
| Nënskrimi:                  |                        | Nënskrimi:        |              |
| Data:                       | 06.02.2018             | Data:             | 06.02.2018   |
| Vula:                       |                        | Vula:             | MITI-N       |



## PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofritesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.
- 1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofritesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofritesit të Shërbimeve.
- 1.3 "Ofrites i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofitesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofitesi i Shërbimeve.
- 1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofitesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përeakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofitesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofitesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofritesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
  - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofritesit të Shërbimeve siguruesve të Ofritesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofritesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofitesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

### Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofitesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### **Neni 5 Tatimi**

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

#### **Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve**

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

#### **Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyet:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

#### **Neni 8 Forca Madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkakuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrrëgullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rreptet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmëtarët, shtrëngatat, vëtëfima, vërsimet, erozionet,

trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofriuesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofriuesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofriuesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përvèç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

#### Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofriuesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofriuesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kérkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofriuesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofriuesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofriuesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofriuesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofriuesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rendë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofriuesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligor, natyrën ose kontrollin e Ofriuesit të Shërbimeve, përvèç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofriuesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofriuesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruejë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofriuesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëherëshëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpert kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### **Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve**

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

#### **Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve**

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrues i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tillë do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkese me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një

do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identikuara.

#### Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “Menaxherin e Projektit”, i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

#### Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i sherbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha sherbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së sherbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Sherbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Sherbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit sherbime parandalon përdorimin e zakonshëm të sherbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Sherbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënen e pjesës së mbetur të sherbimeve. Ofruesi i sherbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kérkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendor qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kérkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendor qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofrcesi i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofrcesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

#### Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofrcesi i sherbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofrcesit të Sherbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

#### Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofrcesi i Shërbimit

15.1 Ofrcesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuar nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofrcesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

#### Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se leshuar nga Ofrcesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofrcesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i reportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendare nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofrcesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëherëshëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofrcesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofrcesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kérkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të rezbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jalin të drejtë Ofrcesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofrcesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë

autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

## Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KVK.

## Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

## Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërpërje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpérblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

## Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekte për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetërni me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkessës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkessës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkessave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

## Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## Neni 22 Dëmshpërbimi

22.1 Ofriuesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbilej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofriuesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofriuesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofriuesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofriuesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë

### PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbl ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | Përshkrimi i nenit | Nr. Nenit | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK  |
|-------------------------------------|--------------------|-----------|--|
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha        | 2.1                |           | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.  |
| Obligimet e ofruesit te shërbimeve  | 2.2                |           | Gjuha e përdorur do të jetë <i>shqipe</i> .  |
|                                     | 11                 |           | <p><b>Kualiteti i Shërbimeve Ndihmëse .</b></p> <p>Ofruesi i Shërbimeve do të kryej të gjitha shërbimet me cilësi të lartë dhe të paktën në nivelin që është në përputhje me Manualin e Punëtorisë së prodhuesit dhe me çdo ndryshim siç përcaktohet nga autoriteti kontraktues.</p> <p>Aty ku nuk ka udhëzime të veçanta të dhëna nga prodhuesi , Ofroresi i Shërbimeve do të mbajë një standard në përputhje me nivelet më të larta të industrisë se automobilave , në bazë të testimit të meritave për automjete rrugore me standardet e pranueshme të Kosovës .</p> <p>Pjesa e brendshme e automjeteve duhet të jetë e mbrojtur në çdo kohë duke përdorur mbulesa dhe mbrojtje tjetër për të siguruar që në asnjë mënyrë inventari i brendshëm mos të dëmtohet apo të ndotet .</p> <p>Ofruesi i Shërbimeve nuk do të prekë apo të ngacmoj ndonjë pjesë të një automjeti që nuk kërkon inspektimin si pjesë e ofrimit të ndonjë shërbimi sipas kësaj kontrate . Ofroresi i shërbimeve do të jetë përgjegjës përi riparim ose zëvendësim të ndonjë pjesë e cila dëmtohet gjate një prekjeje të tillë të paautorizuar .</p> <p><b>Cilësia e pjesëve rezerve.</b></p> <p>Duhet te përdoren vetëm pjesë dhe materiale te prodhuesit (Genuine Manufacturer's parts).</p> <p>Në rast se pjesët dhe materialet e automjeteve nga prodhuesi (Genuine Manufacturer's parts) nuk janë në dispozicion, (p.sh. për automjetet e vjetra), ofroresi i shërbimeve duhet të informojë menaxherin e projektit të kontratës i cili mund të bie dakord qe te instalohen pjesë standarde ekivalente si OEM (Original Equipment Manufacturer), i cili dakordim duhet te shqyrtohet dhe miratohet nga eksperte teknik te Autoritetit Kontraktuese.</p> <p>Pjesët e vjetra/te zëvendësuara do të jetë pronë e Autoritetit kontraktues dhe do të duhet të kthehen nga Ofroresi i Shërbimeve tek Autoriteti Kontraktues së bashku me inventarët e pjesëve të zëvendësuar.</p> <p>Të gjitha pjesët që kërkojnë zëvendësim duhet të zëvendësohet vetëm me pjesë origjinale dhe garancioni i pjesës së zëvendësuar duhet të depozitohet tek Autoriteti Kontraktues.</p> |
| Obligimet e                         | 12                 |           | <b>Menaxheri i Projektit caktohet me vendim nga ZKA</b>  |

|  |      |  |
|--|------|--|
| Kontraktues                                      |      | <p>parë ), për ofruesin e shërbimit çdo automjet për te cilin kërkohet servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt. Autoriteti Kontraktues do të përpinqet qe të vë automjetet në dispozicion për servisim dhe mirëmbajtje te rregullt në intervalë të caktuar për të shmangur mbingarkesën. Megjithatë , për arsyen operacionale , disa automjete mund të mos jetë në dispozicion për servisimin e rregullt dhe Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar që të vë automjeteve në dispozicion .</p> <p>Ofruesi i Shërbimeve do të njoftohet nga Autoriteti kontraktues kur nevojitet servisimi i rregullt i një automjeti.</p> <p>Riparimet do të kryhen në kohën më të shkurtër të mundshme duke përdorur, <i>kur janë në dispozicion</i>, pjesët që Ofruesi i Shërbimeve i ka në magazinë. Atëherë kur një pjesë nuk është në magazinë, Ofruesi i Shërbimit do të konfirmojë me shkrim tek Autoriteti Kontraktues, datën kur pjesa do të jetë në dispozicion. Afatet kohore për disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit do të jetë 15 ditë pune, (pesëmbëdhjetë).</p> |
| Siguria e ekzekutimit                            | 14.1 | <p>Ofruesi i Shërbimeve, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, do te dorëzoj tek KK Prishtina një sigurim për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës.</p> <p>Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është:</p> <p><b>4,000.00 € (katër mijë Euro)</b> për kohëzgjatjen prej 37 muajve.</p>  |
| Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit | 15.1 | <p>Ofruesi i Shërbimeve do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do të sigurojë Autoritetin kontraktues dhe Menaxherin e Projektit kundër, çdo kërkesë për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ofruesi i shërbimit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tij.</p> <p>Ofruesi i Shërbimeve do të jetë tërësisht përgjegjës për automjetet, gjersa ata janë në objektet e tyre dhe duhet të jetë i siguruar në përputhje me rrëthanat. Çdo dëmtim i shkaktuar do të korrigohet nga ofruesi i shërbimeve në shpenzime të veta.</p> <p>Ofruesi i Shërbimeve duhet të sigurojë që i gjithë stafi i tij, i cili vozit veturat dhe kryen testin e rrugor për automjete, janë të siguruar plotësisht dhe kane patentë shoferin për kategorinë e automjeteve që vozitin.</p>  |
| Parimet të përgjithshme të pagesave              | 16   | <p>Pagesa do të autorizohet nga Autoritet Kontraktues ne baza mujore (ex post) sipas konsumit aktual. Nuk ka pagesa paraprake.</p> <p>Kërkesat për pageset do të bëhet në baza mujore ( ex post) sipas konsumit aktual dhe lëshimit te faturave.</p> <p>Brenda 10 (dhjetë) ditë pune pas përfundimit të çdo muaji, Ofruesi i Shërbimeve duhet të dorëzoj tek AK një faturë origjinale dhe një kopje për shërbimet e kryera gjatë muajit të tillë. Të gjitha faturat e dorëzuara duhet të deklarohen në Euro.</p>   |
| Kualiteti i Kontrollit                           | 17.1 | <p>Ofruesi i shërbimeve do të garantojë që furnizimet të janë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përvèç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Ofruesi i shërbimeve do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme <b>një vit</b> pas pranimit te përkohshëm.</p> <p>Ofruesi i Shërbimeve do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonië pjesë të furnizimeve të cilat</p>   |

|   |      |   |
|---|------|---|
|   |      | <p>dhe të cilat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Ofruesi i Shërbimeve; ose</li> <li>b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Ofruesi i Shërbimeve gjatë periudhës së garancisë; ose</li> <li>c) shfaqen gjatë ndonjë inspekimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.</li> </ul> <p>Ofruesi i Shërbimeve me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet.</p> <p>Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.</p> <p>Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) të korrigojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Ofruesit te Shërbimeve, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhen ose garancitë që mbahen prej Ofruesit te Shërbimeve ose nga të dy; ose</li> <li>b) të ndërpresë kontratën.</li> </ul> <p>Në raste urgjente, kur ofruesi i shërbimeve nuk mund të gjendet menjëherë, ose, edhe nëse është kontaktuar por është në gjendje të marrë masat e nevojshme, Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i Projektit mund të kryejnë punën ne shpenzime të Ofruesit të Shërbimeve. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i Projektit do të informoj sa më shpejt të jetë e mundur Ofruesin e Shërbimeve për veprimin e marrë .Periudha e përgjegjësisë së Defekteve është <b>37 muaj</b></p> |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes               | 20.2 | Përmes Zyrtarit Kryesor Administrativ   |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore | 21.1 | <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet gjykatën kompetente në pajtim me ligjin në Kosovë.<br/>ose</li> <li>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të në pajtim me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht.</li> </ul>  |

## SHËNIM

**Pjesa C:** - Formulari i Dorëzimit të Ofertës – ky formularë duhet të përdoret vetëm nëse tenderi dorëzohet në kopje fizike. Përndryshe, në qoftë se tenderi dorëzohet në mënyrë elektronike, formulari krijohet përmes sistemit.

## **PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT**

### **Pjesa I. Formulari i Tenderit**

Për: **KOMUNA E PRISHTINES**  
(në vazhdim të tekstit “Autoriteti Kontraktues”)

**Titulli i kontratës: Servisimi dhe mirembajtja e automjeteve te Komunes - pjesa e II-te**

Si përgjigje ndaj letrës suaj të fletës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përbajtjet e dosjes së tenderit me Numër të Prokurimit: **616 17 004 221**. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërsi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

3. Çmimi total i tenderit është:

Çmimi i tenderit në shifra: **[326,885.20 €]**

Dhe në fjalë **[Treqind e njëzet e gjashtë mijë e tetë qind e tetëdhjetë e pesë pikë njëzet Euro/Cent]**



4. Ky tender është valid për një periudhë prej **[90 ditëve]** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. [Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës **[10% shëno vlerën ose përqindjen e sigurisë]**].

6. Operatori Ekonomik (“**NITI-N**” SH.P.K) kanë këtë nacionalitet: **[SHQIPTAR]**

7. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender **[Loto 2 dhe 2.I]**, me të drejtën tonë të udhëhequr nga ne. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër

**[Në rast të konsorciumit]**

**[Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë]**

me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës].

8. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informata e pasakta ose jo të plota të cilat jepen më qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të finançuara nga BKK.

9. Thesojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

### E DORËZUAR NGA

| IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK |   |
|-----------------------------------|---|
| <b>EMRI I KOMPANIËS</b>           | “NITI-N” SH.P.K   |
| <b>ADRESA E PLOTE</b>             | ULPIANA A1-LOK 2A   |
| <b>PËRFAQËSUAR NGA:</b>           |   |
| <b>EMRI &amp; MBIEMRI</b>         | NAIM ZYMERI   |
| <b>POZITA</b>                     | DREJTOR   |
| <b>NËNSHKRIMI</b>                 | <i>N. Zymeri</i>  |
| <b>DATA</b>                       | 04/01/2018  |
| <b>VULA</b>                       |  |

[Në rast Grupi Operatorësh ekonomik:]

|                    | Emri (emrat) | Vend-selia |
|--------------------|--------------|------------|
| <b>Partneri 1*</b> |              |            |
| <b>Etj ... *</b>   |              |            |

\* shtoni/fshini reshta plotësues për partnerët sipas nevojës. Vini re që nënkontraktuesi nuk konsiderohet si partner për qëllime të kësaj procedure të tenderit.

**Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për të nënshkruar këtë tender në emër të Konsorciumit: [shëno emrin dhe mbiemrin]**

**Nënshkrimi: [\_\_\_\_\_ nënshkrimi i personit të autorizuar]**

**Vendi dhe data: [\_\_\_\_\_ shëno vendin dhe datën]**

**Vula e Udhëheqësít: \_\_\_\_\_**

in

## R E K A P I T U L I M

| Nr                             | Përshkrimi i artikulli   | Çmimi        |
|--------------------------------|--|--------------|
| 1                              | Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve sipas përshkrimit te çmimit ne EXEL – lot2   | 143,161.20   |
| 2                              | Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve sipas përshkrimit te çmimit ne EXEL – lot2.1 | 183,724.00   |
| Gjithsej çmimi i poentuar 1+2: |  | 326,885.20 € |

| IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)         |   |
|--|---|
| <b>EMRI I OE:</b>                              | “NITI-N” SH.P.K   |
| <b>EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TE OE:</b> | ULPIANA A1-LOK 2A   |
| <b>NËNSHKRIMI:</b>                             |  |
| <b>DATA:</b>                                   | 04/01/2018  |
| <b>VULA:</b>                                   |   |

.0T 2

sa 1: Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjetave







1

|                         | çmimi total  | çmimi total i peshuar |
|-------------------------|--------------|-----------------------|
| A - Gjithsej (1-3):     | € 13,710.00  | € 8,226.00            |
| B - gjithsejt (1-237) : | € 602,196.00 | € 120,439.20          |
| C - gjithsejt (1-19):   | € 48,000.00  | € 2,400.00            |
| D - gjithsejt (1-52):   | € 80,640.00  | € 12,096.00           |

**Çmimi i TOTAL i peshuar (ofertat do te vleresohen ne baze te kesaj vlere). Kjo ështe vlera e cila do te duhet te shenohet ne Formularin e ofertes dhe do te lexohet gjate hapjes publike.**

*[Signature]*

| Emri i OE:                              | Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)  |
|---|--|
| Emri dhe mbiemri i perfaquesesit te OE: | "NITI-N" SH.P.K                          |
| Nenshkrimi:                             | <b>NAIM ZYMERI</b><br><i>Naim Zymeri</i> |
| Data:                                   | 04-01-18                                 |
| Vula:                                   |  |

OT 2.1

sa 1: Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve









|                         | çmimi total  | çmimi total i peshuar |
|-------------------------|--------------|-----------------------|
| A - Gjithsej (1-3):     | € 17,025.00  | € 10,215.00           |
| B - gjithsejt (1-237) : | € 765,727.50 | € 153,145.50          |
| C - gjithsejt (1-19):   | € 64,820.00  | € 3,241.00            |
| D - gjithsejt (1-52):   | € 114,150.00 | € 17,122.50           |

*Çmimi i Pergjithshem i peshuar (ofertat do te vleresohen ne baze te kesaj vlera). Kjo është vlera e cila do te duhet te shenohet ne Formularin e ofertes dhe do te lexohet gjate hapjes publike.*

*H*

| Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE) |                   |
|---|-------------------|
| Emri i OE:                              | "NITI-N" SH.P.K   |
| Emri dhe mbiemri i perfaqesuesit te OE: | NAIM ZYMERI       |
| Nenshkrimi:                             | <i>Njësia KPK</i> |
| Data:                                   | 04-01-18          |
| Vuia:                                   | INITIALS          |





**Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

**KOMUNA E PRISHTINËS**

Zyrtari kryesor administrativ

014 nr. 370/02-31378/18 më: 07-02-2018

Në bazë të dispozitave të nenit 81 të Ligjit 04/L - 042 të prokurimit publik, pikës 8.1, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, shkronja (g) të Udhëzuesit Operativ për prokurim publik, Kryetari i Komunës në cilësin e Zyrtarit kryesor administrativ, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Caktohet Menaxheri i projektit dhe mbikqyresit për kontratën:**

Titulli i tenderit: **Servisimi dhe mirembajtja e automjeteve te Komunes – pjesa e II-ë**

Nr. i prokurimit: **616 17 004 221**

Drejtoria: **Drejtorati për Administratë të përgjithshme**

**II. Menaxheri i projektit sipas pikës I te këtij vendimi caktohet:**

**Emri dhe mbiemri:** **Drejtoria**

Adil Canolli Brigada e Zjarrfiksave -- per automjetet e BZ

Shaban Maliqi Drejtoria e Administratës – për automjete e komunës

**III. Mbikqyrës për realizimin e kontratës sipas pikës I të këtij vendimi caktohen:**

**Emri dhe mbiemri:** **Drejtoria**

Ibrahim Emini Brigada e Zjarrfiksave -- per automjetet e BZ

Rifat Gashi Drejtoria e Administratës – për automjete e komunës

**IV. Manaxheri i projektit është përgjegjës sipas nenit 81 të LPP - së dhe nenit 55 të Udhëzuesit Operativ për prokurim publik dhe menaxhimin (mbikqyrjen) e kontratës sipas kushteve të saj. Menaxheri i projekti do të përgaditë planin e Menaxhimit të Kontratës duke përdorur Formularin Standard të miratuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe të informoj Zyrtarin e Prokurimit.**

**V. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.**

Vendimi i'u dorëzohet: Menaxherit dhe mbikqyrësve të kontratës, Departamentit të prokurimit dhe Drejtorit të Drejtorisë përkatëse të projektit.

**Zyrtari kryesor administrativ  
Shpend Ahmeti**